



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.80/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelin e Denat Rashica nga Vushtrria, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve, për Zgjedhjet e parakohshme Parlamentare që do të mbahen 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 23.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i pasafatshëm apeli i identifikuar me numër: Anr.80/2019, i datës 23.09.2019, i paraqitur nga Denat Rashica, me të cilin ka kërkuar që të përfshihet në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 23.09.2019 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Denat Rashica, në të cilin paraqitsi i apelit, pretendon se i është mohuar e drejta për të votuar, pasi që të njëjtit iu është refuzuar kërkesa, për tu futur në listën e votuesve jashtë Kosovës, me arsyetimin se herën e parë, kërkesën për aplikim e ka dorëzuar vetëm me formular të aplikimit, ndërsa herën e dytë sipas paraqitsit të apelit ka plotësuar kushtet për të hyrë në listën e votuesve. Paraqitsi i apelit, i ka bashkangjitur apelit, formularin për aplikim si votues jashtë Kosove si dhe dokumentet e identifikimit, andaj ka kërkuar nga PZAP-i, që t'i mundësohet e drejta në përfshirjen e listës së votuesve.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pasafatshëm

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i paraqitur nga Denat Rashica kundër vendimit të KQZ-së, është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 122 paragraf 1 të LZP-së, me të cilën përcaktohet se: *“Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP, brenda (24) orëve”*. Në këtë kuptim nga shqyrtimi i

shkresave të lëndës rezulton se periudha e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, ka filluar nga data 30.09.2019 dhe ka përfunduar me datën 10.09.2019. Vendimi i KQZ-së, për Certifikimin e Listës së Votuesve, është publikuar me datën 19.09.2019, ndërsa afati për ankesa ka qenë 24 (njëzetekatër), orë nga marrja e vendimit. Apeli në PZAP, nga paraqitsi i apelit, është paraqitur me datë 23.09.2019, çka do të thotë se apeli është parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 122 par.1 të LZP-së.

Nga arsyet e theksuara më lartë në kuptim të nenit 115 paragraf 1, dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 80/2019 me datën 23.10.2017



**Kryesues i Panelit
Fejzullah Rexhepi**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.